



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë- Ministarstvo Pravde- Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë – Ured Ministra Pravde – Office of Minister of Justice

Nr. 140 /2024

Datë: 10/06 / 2024

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10, (paragrafi 1 dhe 2), dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (GZ, Nr.7/01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-118 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në përputhje me nenin 53 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe në pajtim me Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores QRK-nr. 14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive dhe nenin 46 (paragrafi 1) të Rregullores ZKM-Nr. 10/2023 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës së Ministrisë së Drejtësisë, Ministria e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për shfuqizimin e vendimit nr. 110/2024, dt. 03.05.2024

1. Aprovohet kërkesa e datës 10.06.2024 e znj. Artë Ademi-Bajrami, Udhëheqëse në DKPBJMFPAPPGjDhS/MD për lirim nga detyra.
2. Shfuqizohet vendimi nr. 110/2024, dt. 03.05.2024, me të cilin znj. Artë Ademi-Bajrami është emëruar Udhëheqëse e Divizionit për koordinimin e procesit për mbrojtjen juridike dhe mbështetjen financiare të personave të akuzuar potencial në proceset gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara, në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, ashtu që e njëjta lirohet nga detyra.
3. Obligohet Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Me vendimin nr. 110/2024, dt. 03.05.2024, znj. Artë Ademi-Bajrami është emëruar Udhëheqëse e Divizionit për koordinimin e procesit për mbrojtjen juridike dhe mbështetjen financiare të personave të akuzuar potencial në proceset gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara, në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.

Duke pas parasysh kërkesën e të lartcekurës të datës 10.06.2024 për lirim nga detyra për shkak të përzgjedhjes për pozitën Udhëheqës i divizionit për qasje në drejtësi, mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj gruas dhe dhuna në baza gjinore në Departamentin për Qasje në Drejtësi Tranzicionale dhe Mbështetje të Viktimave të Krimin /Ministria e Drejtësisë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Abulena HAXHIU**
Ministre e Drejtësisë

Vendimi iu dërgohet:

- Znj. Artë Ademi-Bajrami;
- Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretares së Përgjithshme/MD;
- Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme;
- Divizionit për KPMJMFAPPGjDhS/MD;
- Arkivit të MD-së.